



Breaking News:

DVP Korçë, gjatë 24 orëve të fundit



Lajmet

10/01/2025

Durrës – Qëlloi Me Armë Zjarri Në Ajër, Gjatë Një Konflikti Për Motive Të Dobëta, Me Një Bashkëmoshatar Të Tij, Kapet Dhe Vihet Në Pranga 17-Vjeçari

Durrës

Qëlloi me armë zjarri në ajër, gjatë një konflikti për motive të dobëta, me një bashkëmoshatar të tij, kapet dhe vihet në pranga 17-vjeçari.

Sekuestrohet në cilësinë e provës materiale arma e zjarrit pistoletë.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Durrës, në vijim të punës për kapjen e personave të shpallur në kërkim, bazuar në inteligjencën policore dhe kontrollet e ushtruara, bënë të mundur kapjen dhe ndalimin e shtetasit A. K., 17 vjeç, banues ne Sukth, Durrës.

17-vjeçari ishte shpallur në kërkim, pasi më datë 07.01.2025, rreth orës 15.30, në fshatin Kullë, Durrës, është konfliktuar për motive të dobëta, me shtetasin H. M., bashkëmoshatar i tij, dhe gjatë konfliktit ka qëlluar me armë zjarri, në ajër.

Shërbimet e Policisë kanë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale, armën e zjarrit pistoletë me të cilën dyshohet se 17-vjeçari ka qëlluar në ajër gjatë konfliktit për motive të dobëta.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit te Përgjithshëm Durrës, për veprime të mëtejshme, për veprat penale “Prishja e qetësisë publike” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe municionit”.



◀ DVP Korçë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Crackman”

Policia, me dyer të hapura për nxënësit dhe qytetarët, në kuadër të 112-vjetorit të krijimit të saj ▶

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)